

L I G J
Nr.7758, datë 12.10.1993

PËR DOKUMENTIMIN DHE MBAJTJEN E LLOGARIVE PËR TATIMET

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 20.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton detyrimet kryesore dhe rregullat bazë që do të zbatohen nga subjektet, mbi të cilat ai vepron lidhur me dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimin, qarkullimin, për akcizat, për tatimin mbi biznesin e vogël dhe për çdo tatim tjetër të ngjashëm.

Neni 2

Ky ligj vepron mbi çdo subjekt, person fizik, i cili ushtron veprimtari profesionale dhe është detyrues i njërit nga llojet e tatimeve të parashikuara në nenin "1" të këtij ligji.

Për zbatimin e këtij ligji, me termat që vijojnë duhet kuptuar:

Me "veprimtari profesionale" çdo veprimtari prodhimi, tregtie punimi e shërbimi, duke përfshirë edhe profesionet e lira.

Me "i detyruar" çdo person fizik a juridik që realizon veprime ekonomike të tatueshme dhe është pagues i një tatimi.

Neni 3

Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe, të gjitha detyrimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", dhe në aktet e tjera të natyrës kontabël janë të zbatueshme.

KREU II
FATURAT DHE DOKUMENTET E TJERA JUSTIFIKUESE TATIMORE

SEKSIONI 1
FATURA

Neni 4

Çdo blerje sendesh ose çdo kryerje punimi e shërbimi që destinohen për një veprimtari profesionale është objekt faturimi.

Çdo faturë duhet të përmbajë numrin, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit a shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rabatat ose zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

Faturat për shitjen e sendeve a kryerjen e punimeve e të shërbimeve, të cilat janë objekt i kërkimit të një tatimi, janë fatura tatimore.

Neni 5

Përveç përshkrimeve dhe të dhënave të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 4, fatura tatimore duhet të përmbajë:

- çmimin mbi të cilin përllogaritet tatimi i kërkuar,
- llojin dhe tarifën e tatimit të zbatuar sipas kategorive të sendeve, punimeve e shërbimeve,
- shumën e tatimit.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë mund të përcaktojë kërkesa të tjera që duhet të përmbajë një faturë tatimore për rastet e veçanta që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive ose të sendeve, punimeve dhe shërbimeve.

DOKUMENTE QË ZENË VENDIN E FATURËS

Neni 6

Çdo dokument tjetër që lëshohet për veprimet dhe qëllimin e parashikuar në nenin 4 e që përmban përshkrimet dhe të dhënat e një fature, quhet i njëvlershëm me këtë të fundit, cilito qoftë emërtimi i dokumentit.

LËSHIMI I FATURËS

Neni 7

Shitësi është i detyruar të lëshojë faturë dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes a të kryerjes së punimit ose shërbimit.

Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy ekzemplarë, nga të cilët njërin e merr dhe e ruan blerësi, kurse kopjen e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

Me rezervën e dispozitave të kundërta faturat tatimore ruhen për gjashtë vjet.

FATURA TË PËRGATITURA NGA BLERËSI

Neni 8

Në rastin e blerjeve nga individët që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga vetë blerësi, ushtrues i veprimtarisë profesionale, por me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji dhe të vërtetohet nga furnizuesi.

Për zbatimin e kësaj dispozitë Ministria e Financave dhe e Ekonomisë mund të përcaktojë ose të miratojë forma të posaçme dokumentesh që zënë vendin e faturës.

SEKSIONI II

DËFTESAT DHE KUPONAT TATIMORE

Neni 9

Në kuptim të këtij ligji është dëftesë tatimore dokumenti që një subjekt tatimpagues, person fizik a juridik, u lëshon individëve të veçantë për shitjen e sendeve, kryerjen e punimeve ose të shërbimeve për përdorim vetjak. Dëftesë tatimore, në raste të caktuara, lëshohet edhe për shitjet, punimet a shërbimet e kryera për përdorim në veprimtaritë profesionale.

Dëftesat tatimore të lëshuara me anë të arkave regjistruese a të pajisjeve elektronike të tjera që kanë aparat shtypshkrimi quhen, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, kupona tatimore.

DETYRIMI PËR LËSHIMIN E KUPONAVE TATIMORE

Neni 10

Sipas një radhe përparësish të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, detyrimi për vendosjen e arkave regjistruese dhe për lëshimin e kuponave tatimore do të shtrihet mbi shitjet e mallrave e të prodhimeve ose kryerjen e furnizimeve e të shërbimeve të parashikuara në nenin 9, të cilat kryhen në lokale a njësi të tjera të përhershme të hapura për publikun. Ky detyrim do të shtrihet gjithashtu mbi ndërmarrjet dhe entet shtetërore e private që realizojnë shitje të brendshme për personelin e vet, për të cilat nuk lëshohet faturë.

LËSHIMI I DËFTESAVE TË TJERA TATIMORE

Neni 11

Kategoritë e tatimpaguesve dhe të veprimeve që do t'i nënshtrohen detyrimit për lëshimin e një dëftese tatimore, të ndryshme nga kuponi tatimor, përcaktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë përcakton gjithashtu rregullat dhe mënyrat e dokumentimit të të ardhurave, objekt i kërkimit të një tatimi, në rastet kur nuk ka detyrim për lëshimin e dëftesave tatimore.

LËSHIMI NJËHERAZI I KUPONIT TATIMOR DHE I FATURËS

Neni 12

Subjektet që detyrohen të lëshojnë kupona tatimore, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim profesional dhe për këtë shkak blerësi është i detyruar t'a kërkojë faturën.

Kuponi tatimor nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie, pa qenë shoqëruar me faturë.

KREU III

DISPOZITA PËR ARKAT REGJISTRUESE DHE KUPONAT E LËSHUARA ME ANË TË TYRE

Neni 13

Vendosja dhe përdorimi i arkave regjistruese bëhet me udhëzim të miratuar nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, ku përcaktohen:

- karakteristikat që duhet të kenë, mënyrat e blerjes dhe të kontrollit përpara instalimit të tyre;
- mënyrat e kontrollit gjatë përdorimit, personat e autorizuar për hapjen dhe mënjanimin e defekteve dhe rregullat që zbatohen për lëshimin e kuponave në rastet dhe për kohën e mosfunksionimit të aparatit;
- rregullat dhe mënyrat e furnizimit me material regjistruese;
- rregullat për lëshimin, për përmbajtjen dhe regjistrimin e kuponave tatimore, si dhe për mënyrën dhe afatet e ruajtjes së tyre.

Arkate regjistruese, me të cilat përdoruesit pajisen nga ndërmarrjet e autorizuar për shitjen ose dhënien me qira të tyre, duhet të jenë të njëllajtja edhe për mekanizma të veçantë, me modelin e miratuar dhe të depozituar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe duhet të ofrojnë garanci të plotë për një furnizim normal.

SHKELJET DHE SANKSIONET

Neni 14

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji për vendosjen dhe përdorimin e arkave regjistruese, për lëshimin e kuponave tatimore dhe ruajtjen e tyre, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si

vijon:

a) Për ata që, duke qenë të detyruar, nuk vendosin në lokalet e tyre arkat regjistruese ose një aparat tjetër të caktuar, organi i administratës tatimore vendos pezullimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në lokalin e dhënë për një periudhë jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë dhe jo më shumë se gjashtëdhjetë ditë.

Ky sanksion zbatohet edhe për rastet kur në lokal vihen në përdorim aparate të ndryshme nga ato që janë parashikuar.

b) Ata që, duke qenë të detyruar, nuk lëshojnë kuponin tatimor dënohen për çdo rast me gjobë njëqindmije lekë, ndërsa ata që e lëshojnë atë me një shumë me të vogël se vlera reale, dënohen për ato raste me gjobë pesëdhjetëmijë lekë.

Nëse gjatë dymbëdhjetë muajve të njëpasnjëshëm numri i shkeljeve të vërtetuara për moslëshimin e kuponit apo të regjistrimit të një shume më të vogël se ajo reale është më shumë se dy shkelje, zbatohet masa e pezullimit të lejes për ushtrimin e veprimtarisë, të parashikuar në shkronjën "a".

c) Çdo shkelje tjetër, duke përfshirë edhe atë të mosmarrjes nga blerësi të kuponit tatimor, dënohet me gjobë nga njëmijë deri në pesëmijë lekë.

Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i kundërvajtjeve administrative të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të këtij neni bëhet nga organet tatimore dhe të policisë financiare të juridiksionit ku shkelësi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljen, në pajtim me dispozitat e kreut të dytë të ligjit nr.7697, datë 7.5.1993 "Për kundërvajtjet administrative". Ankimi kundër vendimit të dënimit të organit administrativ bëhet sipas rregullave të nenit 18 të ligjit të sapocituar.

Neni 15

Kushdo që me qëllim të shmangies së zbatimit të dispozitave për përdorimin e arkave regjistruese ose të aparateve të ngjashme të parashikuara ndërhyn ose ndryshon (falsifikon) aparatet matëse, përdor vetë ose lejon përdorimin nga të tjerët të aparateve të ndryshuara, dënohet me gjobë nga 300 mijë deri në 500 mijë lekë, ose me heqje të lirisë deri në tre vjet.

Këtij dënimi i nënshtrohet cilido që, për të njëjtin qëllim, harton materiale të stampuara, dokumente e regjistra të falsifikuar dhe përdor ose lejon të përdoren nga të tjerët këto materiale, dokumente e regjistra.

Konstatimi dhe kallzimi për ndjekje penale për shkeljet e parashikuara në këtë nen bëhet nga organet tatimore dhe të policisë financiare të juridiksionit ku shkelësi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

KREU IV

MBAJTJA E KONTABILITETIT PËR TATIMET DHE TAKSAT

LIBRAT KONTABËL TATIMORE

Neni 16

Çdo subjekt që i nënshtrohet këtij ligji, person fizik a juridik, duhet të regjistrojë në mënyrë të plotë, të rregullt dhe në kohën e duhur të gjitha veprimet e kryera, me qëllim që të justifikojë shumën e tatimeve e të taksave për të cilat detyrohet, derdhjen a pagimin e tyre, si dhe të japë elementët e nevojshëm për kontrollin nga administrata tatimore ose nga organe të tjera të autorizuar me ligj.

Për regjistrimin e veprimeve ekonomike që lidhen me tatimet dhe taksat përdoren librat a regjistrat e kontabilitetit që subjekti mban në zbatim të detyrimeve kontabël. Nëse librat e kontabilitetit të mbajtur normalisht rezultojnë të pamjaftueshme ose nuk përmbushin kërkesat ligjore për tatimet dhe taksat atëherë përdoren libra të posaçëm.

Llojet dhe format e librave të posaçëm përcaktohen me udhëzime të veçanta të miratuara nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

RREGJISTRIMI I VEPRIMEVE, SHUMAT E TË CILAVE JANË OBJEKT I LLOGARITJES SË TATIMIT

Neni 17

Çdo detyrues për tatimet e kërkuara mbi shitjen e sendeve ose mbi kryerjen e punimeve e të shërbimeve duhet të regjistrojnë nga dita në ditë shumat e çdo veprimi të kryer.

Përveç veprimeve të tatueshme në librin kontabël ose në librin e posaçëm, duhet të vihen në dukje në mënyrë të dalluar edhe:

- veprimet e patatueshme;
- veprimet e kryera, por të mbetura pezull për tatimin e dhënë;
- për çdo blerje të sendeve, punime e shërbime treguesin e shumës së tyre, të tatimit përkatës, si dhe emrin dhe adresën e furnitorit;
- për çdo veprim shitjeje, kryerje punimi a shërbimi, shumën sipas çmimit të shitjes, shumën e tatimit sipas tarifës së zbatuar, si dhe emrin e adresën e klientit.

Kur shitjet kryhen me çmime në të cilat është përfshirë edhe shuma e tatimit ose kryhen shitje me para në dorë të artikujve për të cilat zbatohen tarifa të ndryshme tatimi, llogaritja dhe regjistrimi i shumave të tatimit bëhet sipas mënyrave të caktuara me udhëzim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

LLOGARITË KONTABËL PËR TATIMET DHE TAKSAT

Neni 18

Për ndjekjen kontabël të marrëdhënieve me buxhetin për tatimet dhe taksat, subjektet tatimpagues, persona fizikë a juridikë, përdorin llogaritë e parashikuara në planin e përgjithshëm kontabël dhe në planet kontabël të veçanta.

Nëse për qëllime të përgatitjes së dokumenteve përmbledhëse tatimore dhe të kontrollit administrata tatimore kërkon mbajtjen e llogarive të tjera që nuk janë parashikuar në planet kontabël, kjo duhet të bëhet me një rregullim të përgjithshëm nga organi që ka miratuar planin kontabël përkatës, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 3 dhe 4 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin".

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.679 datë 3.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.